



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 620/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.08.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr.1175 prot., dt. 27.06.2017 për procedurën konkurruese “Procedurë e Hapur”, me objekt: “Dhënie me koncesion të Hidrocentralit Bushtrica 1”, me nr. REF-09833-04-27-2017, zhvilluar në datën 31.05.2017, nga autoriteti kontraktues Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

Ankimues: “2 T” sh.p.k.
Adresa :Rruga “Hasim Vokshi”, Nd. 14, h 4, Ap. 5,
Tiranë

Autoriteti Kontraktues: Ministria e Energjisë dhe Industrisë
Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, VKM nr. 575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/partneritet publik privat”, VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë koncesionare dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat konkurruese, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.04.2017 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura konkurruese “Procedurë e Hapur”, me objekt: “Dhënie me koncesion të Hidrocentralit *Bushtrica 1*”, me nr. REF-09833-04-27-2017, zhvilluar në datën 31.05.2017, nga autoriteti kontraktues Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

II.2. Në datën 31.05.2017, autoriteti kontraktues ka zhvilluar procedurën e mësipërme të koncesionit/partneritetit publik privat.

Në procedurën koncesionare/partneriteti publik privat kanë paraqitur interes operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

- i. 2T shpk
- ii. Doko shpk

II.3. Në datën 14.06.2017 autoriteti kontraktues, me anë të shkresës nr. 1440/4 prot., ka publikuar renditjen (klasifikimin) e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë koncesionare/partneriteti publik privat, nga ku rezulton si më poshtë vijon:

- i. 2T i skualifikuar
- ii. Doko i kualifikuar dhe vlerësuar me 100 pikë

II.4.. Në datën 27.06.2017 operatori ekonomik ankimues, shoqëria “2 T” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke pretenduar si më poshtë vijon:

- *Me anë të shkresës datë 14.06.2017 nr.4517 prot (marrë dije referuar mandatit postar datë 16.06.2017) me lëndë Njoftim për ofertuesin e skualifikuar AK na vuri në dije ndër të tjera se: Me keqardhje ju informoj se i skualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes së mëposhtme: Shoqëria juaj nuk e ka plotësuar dhe dorëzuar në mënyrë të rregullt shtojcën 1 “Formulari i Ofertës” i cili në kundërshtim me përcaktimet e gërmes ç të shtojcës 9 të dokumentave të koncesionit ku citohet se: Për të vërtetuar se operatorët ekonomikë janë të kualifikuar ofertuesi duhet të paraqesë ç) Përshkrimi i ofertës i plotësuar dhe nënshkruar në mënyrën e duhur sipas shtojcës 1. Ky vendim i AK-së është dukshëm i kundraligjshëm dhe gjykojmë se ky vendim duhet ndryshuar pasi sqarojmë se: Në dokumentat e koncesionit AK ka parashikuar ndër të tjera dhe formularin e ofertës duke përfshirë dhe kërkuar zërat si : Fuqia e Instaluar me njësi matëse KW, Vlera e Fee koncesionare me njësi matëse %, Analiza ekonomike dhe financiare, Kapaciteti financiar, Ndikimi ekologjik social, Skema e lidhjes së centralit me sistem elektroenergjitik, Koha e zbatimitme njësi matëse Muaj, Kosto për makineri dhe pajisje dhe teknologjia e tyre me njësi matëse lek/KW, Vlera e Investimiit (pa tvsh)*
- *Sa më sipër sqarojmë se nga ana e shoqërisë “2T” shpk është paraqitur oferta jonë ku ndër të tjera kemi përfshirë zërat e kërkuar si më poshtë: Prodhim vjetor i energjisë elektrike, Fuqia e Instaluar, Koha e zbatimit të punimeve, Vlera e Investimit, Kosto për njësi për makineri dhe pajisje për KW fuqi të instaluar, Vlera e Fee koncesionare (e shprehur në % të energjisë elektrike vjetore të prodhuar. Sa më sipër lehtësisht vërhet se nga ana e shoqërisë 2T shpk në ofertën e paraqitur prej tij janë përfshirë të gjithë zërat e kërkuar nga AK për të cilët ofertuesi mund të plotësojë dhe deklarojë në ofertën e tij. Për s ai përket zërave Analiza ekonomike dhe financiare , “Kapaciteti financiar”, Ndikimi ekologjik social”, Skema e lidhjes së centralit me sistemin elektroenergjitik këto janë zëra të pamundur për tu përcaktuar nga ofertuesi në formularin e ofertës pasi sqarojmë se këto zëra të cilat vlerësohen nga AK në raport me ofertuesin tjetër pjesmarrës, shpjegim të cilin e gjeni lehtësisht në dokumentat e koncesionit e konkretisht në shtojcën 10 Kriteret e Vlerësimit ku vetë AK sqaron se: Shpjegime për kriteret e përzgjedhjes se fituesit dhe metodologjinë e vlerësimit gjatë procedurës konkurruese: Analiza ekonomike dhe financiare duhet dorëzuar ne përputhje me udhëzimet e shtojcës 9. Do të vlerësohet me më shume pikë, ne rastin kur analiza ekonomike dhe financiare kryhet e plote dhe paraqet ne mënyrë te drejte llogaritjen e treguesve te performances financiare si ne rastin e supozuar baze ashtu dhe ne llogaritjen e tyre nëpërmjet kryerjes se testeve te ndjeshmërisë. Ne këtë mënyrë, do te gjykohej per fizibilitetin e investimit te propozuar.*

- Kapaciteti financiar Gjendja e shoqërisë e vërtetuar me dokumentat bankare te paraqitura. Piket maksimale do ti marr ofertuesi (ne rastin e bashkimit te perkohshme shumatorja e gjendjes se secilit anëtar) i cili disponon me shumë gjendje, në bazë përqindjeje përtej kapacitetit minimal kualifikues ne raport me investimin e propozuar (sipas pikës 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” te shtojcës 9 me 35 sipër) dhe krahasimi midis ofertuesve do te kryhet ne baze te rregullit “te treshit” bazuar gjithnjë te përqindjes shtese përtej përmbushjes se kapacitetit minimal kualifikues.
- Ndikimi ekologjik dhe social i projektit i) Do të vlerësohet me piket maksimale paraqitja e një plani monitorimi të masave zbutëse në lidhje me ndikimin që vepra hidroenergjetike do të ketë në mjedis (florën, faunën, token, ujin, ajrin) si dhe në mikroklimën e ambientit. - 10 pike ii) Investime shtesë të parashikuara në ndihme të infrastrukturës se zonës. - 3 pike Shënim: Informacioni dhe çështjet që duhet të trajtohen në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis përshkruhen Ligjin Nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis“ si dhe ne kërkesat e tjera ligjore bazuar ne kuadrin ligjor rregullator te mjedisit. Megjithatë në raportin VNM mund të trajtohen edhe çështje të tjera të identifikuar gjatë plotësimit të saj. 6. Skema e lidhjes se centralit me sistemin elektroenergjetik (duke analizuar jo me pak se dy variante si dhe argumentimi i variantit të propozuar). Sa më sipër lehtësisht vërehet se zërat e kërkuar nga AK janë të pamundur për tu plotësuar nga ofertuesi pasi ato nuk mund të përshkruhen me një shifër të caktuar prandaj AK ka kërkuar gjithashtu në shtojcën 9 Studimin e fizibilitetit të HEC-it (-ve). Studimi i Fizibilitetit të HEC-it është kompleksi i studimeve ose raporteve të nevojshëm për të realizuar ndërtimin e hidrocentraleve, të cilët shndërrojnë energjinë e ujit në energji elektrike. Për një shfrytëzim optimal të potencialit ujor të rrjedhjes dhe që jep ndikimin më pozitiv në mjedisin ekonomik, social dhe ekologjik të rajonit - studimi i fizibilitetit duhet të përmbajnë raporte të detajuara, në nivel projekt ideje si më poshtë: 1. Studimin Hidrologjik; 2. Raportin Gjeologo-Inxhinierik; 3. Raportin Hidroteknik dhe hidroenergjetik; 4. Studimin për skemën elektrike të centralit dhe lidhjes me sistemin energjetik; 5. Analiza ekonomike dhe financiare; 6. Grafiku i Punimeve; 7. Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedisin ekologjik dhe social; 8. Oponenca e Studimit të Fizibilitetit bëhet nga studio të specializuara dhe licensuara për këtë qëllim;
- Në përmbushje të kërkesës për kualifikim shoqëria 2T shpk ka paraqitur si pjesë të ofertës së saj dokumnetacionin e ngarkuar në sistem si më poshtë: Raporti elektrik, VNM, Plan biznesi. Në përmbajtje të këtyre dokumentave nga shoqëria 2T janë hartuar këto dokumenta si pjesë e ofertës së paraqitur prej nesh dhe në përmbushje të detyrimit ligjor për tu kualifikuar si një ofertë e vlefshme. Për sa i përket pretendimit të mosrenditjes së ofertës sipas materialit grafik të hedhur nga AK ky është një argument qesharak dhe kursesi nuk mund të përbëjë shkak për skualifikim.
- Në dokumentat e tenderit është parashikuar: Vlerësimi i autoriteteit kontraktues do të bazohet në të dhënat dhe vetë përmbajtjen e ofertës dhe nëse është e nevojshme KVO mund të kërkojë sqarime nga ofertuesit të cilat nuk përbëjnë një ndryshim të thelbit të ofertës. Sqarimet duhet të jenë vetëm me shkrim ose dhe të reflektuara në procesverbal. Asnjë ndryshim nuk pëson oferta e paraqitur nga shoqëria 2T shpk.

Zërat e kërkuar nga AK janë të pamundur për tu plotësuar në cfardo rrethane. E vetmja mungesë nëse mund të quhet e tillë është që ato të ishin paraqitur thjesht grafikisht dhe të ishin lënë bosh vendet e parashikuara për tu plotësuar. Sa më sipër gjykojmë se devijimet e ofertës së paraqitur prej nesh nuk ndryshojnë atë materialisht dhe nuk devijonë nga karakteristikat kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në DT.

- 2. Lidhur me ofertën e paraqitur nga ofertuesi tjetër pjesmarrës në këtë procedurë shoqëria Doko shpk gjykojmë se ajo nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DT.
- Së pari ky ofertues nuk plotëson kriterin për sa i përket një pune të ngjashme të realizuar në shumën prej 50% të vlerës që ky ofertues ka ofruar.
- Punët e ngjashme të paraqitura nga ky ofertues nuk janë të ngjashme për sa i përket zërave të prevntivit të paraqitura dhe nuk tregojnë se ky ofertues ka eksperiencën e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.
- Nuk plotëson kriterin ekonomik të kërkuar në DT e konkretisht atë të përcaktuar në pikën 2.2.1
- Nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për të gjithë periudhën e vitit 2017 sic kërkohet në DT për sa i përket fuqisë punëtore e konkretisht: Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 100 punonjës për dy vitet e fundit 2016,2017.
- Ky ofertues në projektin e tij nuk ka respektuar sasinë e ujit ekologjik që do të lihet pa u shfrytëzuar në shtratin e lumit në respektim të ligjit Nr.111/2012 “Për menaxhmin e integruar të burimeve ujore” sasia e lejuar nga ana e tij është me e ulët se ajo e parashikuar në DT.
- Oponenca e studimit të fizibilitetit nuk është bërë e plotë për të gjithë elementët e projektit dhe të raporteve të paraqitura nga ky ofertues. Oponenca nuk është shprehur në mënyrë të detajuar dhe të ketë dhënë një mendim të plotë dhe me përgjegjësi profesionale sic kërkohet në DT fq 28 ku specifikohet: Oponenca e studimit të fizibilitetit të bëhet e plotë për të gjithë elementët e projektit dhe të raporteve të paraqitura më sipër. Oponenca të shprehet në mënyrë të detajuar dhe të japë një mendim të plotë dhe me përgjegjësi profsionale.
- Gjithashtu studio e projektimit nuk ka të gjitha kapacitetet ligjore për hartimin e projektit të propozuar ku krahas pikës 5/f të licencës së projektuesit duhet që edhe secili inxhinier të ketë kategorinë përkatëse për hartimin e studimit përkatës . E njëjta situatë paraqitet edhe për studion dhe inxhinierët që kanë hartuar opoencën e projektit kriter i kërkuar në DT ku parashikohet ndër të tjera: Propozimi për ndërtimin me koncesion të hidrocentralit/eve duhet të projektohet nga studio të licensuara për këtë qëllim dhe të rregjistruara në QKR ky është një kusht skualifikues

II.5. Në datën 04.07.2017 me shkresën nr.1175/2 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik shkresa me nr.4683 datë 04.07.2017, me anë të të cilës është dorëzuar informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me procedurën e dhënies së koncesionit/ppp.

II.6. Në datën 22.08.2017, operatori ekonomik “2T” shpk., ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën konkurruese “*Procedurë e Hapur*”, me objekt: “*Dhënie me koncesion të Hidrocentralit Bushtrica 1*”, me nr. REF-09833-04-27-2017, zhvilluar në datën 31.05.2017, nga autoriteti kontraktues Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktues,

Arsyeton

III.1. Lidhur me kërkesën e shoqërisë “2T” shpk për të hequr dorë nga ankimi i bërë në lidhje me procedurën konkurruese “*Procedurë e Hapur*”, me objekt: “*Dhënie me koncesion të Hidrocentralit Bushtrica 1*”, me nr. REF-09833-04-27-2017, zhvilluar në datën 31.05.2017, nga autoriteti kontraktues Ministria e Energjisë dhe Industrisë., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga *Ligji nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik i drejtohet ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili në nenin 94 “Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pika 1 parashikon se “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”*

III.1.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt ankimimit e tij, dhe si pasojë mos shqyrtimit të ankesës së tij nga KPP lidhur me këto pretendime. Heqja dorë nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues sjell si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 “*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*”, i ndryshuar, VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën konkurruese “*Procedurë e Hapur*”, me objekt: “*Dhënie me koncesion të Hidrocentralit Bushtrica 1*”, me nr.

REF-09833-04-27-2017, zhvilluar në datën 31.05.2017, nga autoriteti kontraktues Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

2. Autoriteti kontraktues lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës konkurruese.

3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1175 Protokolli,

Datë 27.06.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Kryetar
Evis Shurdha

opencorporatesAlbania
The Open Database Of The Albanian Corporates